



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministarstvo Trgovine i Industrije  
Ministry of Trade and Industry



AGJENCIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA  
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

# **RAPORTI I INDIKATORËVE BAZË TË PERFORMANCËS PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË PËR PERIUDHËN: KORRIK – SHTATOR 2017**

**AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS**

**TETOR 2017**

## **PËRMBAJTJA**

I. HYRJE.....	3
II. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE .....	4
III. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHPK-VE .....	4
IV. KOHA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT .....	5
V. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE .....	7
VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA SIPAS VENDIT TË ORIGJINËS ..	7
VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ .....	8
VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË .....	8
IX. PËRFUNDIM.....	10

## I. HYRJE

Ky raport është rezultat i vlerësimit të kryer për tremujorin e tretë të vitit 2017 nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejme “ARBK”) me përkrahjen e Projektit të USAID-it Partneritetet për Zhvillim (në tekstin e mëtejme “USAID PFD”) të disa indikatorëve të performancës lidhur me procesin e regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe, një ekip i përbashkët i përbërë nga zyrtarët e ARBK-së dhe këshilltarët e USAID PFD kanë analizuar një sërë indikatorësh të lidhur me performancën e ARBK-së:

- Kohën për regjistrim të shoqërive tregtare në përgjithësi në Kosovë dhe për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar në veçanti, si dhe sipas komunave;
- Numrin total të shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore dhe sipas numrit total të shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës së shoqërive tregtare;
- Numrin total të degëve të kompanive të huaja të regjistruara sipas vendit të origjinës;
- Numrin e pronarëve, ortakëve ose aksionarëve të huaj të përfshirë në shoqëritë tregtare të Kosovës sipas llojit të shoqërive tregtare;
- Përqindjen e bizneseve individuale në pronësi të femrave, dhe
- Përqindjen e ortakëve ose aksionarëve sipas gjinisë në shoqëritë tregtare në Kosovë.

Në të dhënat për këtë tremujor vërehet një ulje e numrit të ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare në raport me tremujorin e mëparshëm Prill - Qershor 2017. Me avancimin e mëtutjeshëm të procesit të regjistrimit të shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe përpjekjet për funksionalizimin e regjistrimit të plotë elektronik, pritet që numri i indikatorëve dhe cilësia e të dhënave të rriten dhe të pasqyrohen në raportet pasuese.

Ky raport analizon të dhënat e nxjerra nga regjistri i shoqërive tregtare të ARBK-së për shoqëritë tregtare që me ligje të veçanta në Kosovë kërkohen të regjistrohen në ARBK. Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, procesi i regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë është akt formal, administrativ dhe informativ. Rrjedhimisht, ky raport nuk bën ndonjë supozim dhe nuk ofron shifra lidhur me shoqëritë tregtare që janë aktive dhe funksionojnë në Kosovë, mirëpo fokusohet kryesisht në matjen e efikasitetit të ARBK-së dhe qendrave komunale të regjistrimit në zhvillimin e procedurave të regjistrimit ose çregjistrimit të shoqërive tregtare.

Për qëllime të këtij raporti, krahasimi mes mesatareve kumulative të ditëve të tremujorit të kaluar (“vlera e vjetër”) me mesataret kumulative të ditëve të tremujorit aktual (“vlera e re”) është llogaritur duke përdorur formulën e ndryshimit në përqindje<sup>1</sup>.

Për të marrë një pasqyrë më të qartë të numrit, madhësisë, dhe statusit funksional të shoqërive tregtare dhe subjekteve tjera ekonomike të angazhuara në veprimtari ekonomike në Kosovë, ekziston nevoja për një përpjekje më gjithëpërfshirëse duke përfshirë institucionet tjera qeveritare, në radhë të parë Administratën Tatimore të Kosovës dhe Ministrinë e Administratës Publike.

---

<sup>1</sup> Vlera e re (V2) - Vlera e vjetër (V1) ÷ Vlera e vjetër (V1) × 100% = Ndryshimi në përqindje

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera të zbatueshme, ARBK aktualisht regjistron këto forma të shoqërive tregtare: Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, Shoqëri Aksionare, Degë e Kompanisë së Huaj dhe Kooperativë Bujqësore.


## II. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE

Shoqëritë tregtare, siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, kërkohen të regjistrohen në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë ose në njërin nga 29 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare nëpër Kosovë. Kjo pjesë e raportit matë numrin e ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

Grafiku 1 paraqet mesataren totale të ditëve, bazuar në regjistrimin e të gjitha formave ligjore të shoqërive tregtare, përkundër ndryshimeve të mëdha në kohën për regjistrimin e llojeve të ndryshme, p.sh. koha për regjistrimin e një biznesi individual është dukshëm më e shkurtër se koha për regjistrimin e një shoqërie aksionare.

Siç mund të shihet në Grafikon 1 me poshtë, për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2017, numri mesatar i ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare ka rënë nga 1.92 në 1.80 ditë, që paraqet përmirësim prej 6.25%. Mesatarja kumulative e ditëve për tremujorin e kaluar ka qenë 2.14 ditë, që në krahasim me këtë tremujor kur mesatarja kumulative e ditëve ka rënë në 1.79 ditë, paraqet përmirësim prej 16.36%.


Grafiku 1: Numri mesatar i ditëve për regjistrim të shoqërive tregtare, korrik - shtator 2017:



## III. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHPK-VE


Kjo pjesë e raportit analizon kohën për regjistrim të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Grafiku 2 tregon se numri mesatar i ditëve për regjistrimin e një SHPK-je për tremujorin e tretë të vitit 2017 ka rënë nga 2.33 në 2.04 ditë, që paraqet përmirësim prej 12.45%. Mesatarja kumulative e ditëve për tremujorin e kaluar ka qenë 2.51 ditë, që në krahasim me këtë tremujor kur mesatarja kumulative e ditëve ka rënë në 2.10 ditë, paraqet një përmirësim prej 16.33%.

Grafiku 2: Numri mesatar i ditëve për regjistrim të SHPK-ve, korrik - shtator 2017:



Për më tepër, Grafiku 3 tregon mesataren e ditëve për regjistrimin e SHPK-ve në qendrën e regjistrimit të ARBK-së në Prishtinë. Numri mesatar i ditëve për regjistrimin e një SHPK-je në Prishtinë për tremujorin e tretë të vitit 2017 është ngritur nga 2.10 në 2.19 ditë, ku vërehet se ka pasur një rënie të vogël në efikasitetin e regjistrimit të SHPK-ve në Prishtinë prej 4.29%. Mesatarja kumulative e ditëve për tremujorin e kaluar ka qenë 2.77 ditë, që në krahasim me këtë tremujor kur mesatarja kumulative e ditëve ka rënë në 2.08 ditë, paraqet një përmirësim prej 24.91%.

Grafiku 3: Numri mesatar i ditëve për regjistrim të SHPK-ve në qendrën e regjistrimit në Prishtinë, korrik - shtator 2017:



## IV. KOHA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT

Tabela I tregon numrin mesatar të ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas qendrave komunale të regjistrimit të shoqërive tregtare gjatë periudhës I korrik - 30 shtator 2017. Tabela e shfaqur përfshin 29 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë.

Numri total i qendrave të regjistrimit në këtë raport ka ndryshuar nga 28 në 29 qendra të regjistrimit pasi që është shtuar qendra e regjistrimit në komunën e Obiliqit. Mitrovica Veriore përfshin komunën e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit.

Ndarja sipas qendrave të regjistrimit në tabelën më poshtë është krijuar në bazë të dhënave të adresës së regjistruar të shoqërive tregtare. Nëse një shoqëri tregtare e ka adresën e regjistrimit në Gjilan, është përdorur supozimi se shoqëria tregtare është regjistruar në qendrën e regjistrimit në Gjilan, edhe pse ekziston mundësia që ajo shoqëri tregtare të jetë regjistruar në qendrën kryesore të ARBK-së në Prishtinë. Kjo është për arsye se ARBK aktualisht ka një sistem unik të regjistrimit të shoqërive tregtare i cili përfshin të dhënat për shoqëritë tregtare të regjistruara në të gjithë territorin e Kosovës, pra jo sipas qendrës së regjistrimit.

Tabela 1: Numri mesatar i ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas Qendrave për Regjistrimin e Shoqërive Tregtare, korrik - shtator 2017:

Qendra e Regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Mesatarja
Deçan	2.58	1.64	1.57	2.00
Dragash	1.09	1.43	1.33	1.24
Ferizaj	1.80	1.53	1.38	1.59
Fushë Kosovë	2.12	1.61	2.05	1.87
Gjakovë	1.24	1.25	2.29	1.72
Gjilan	1.91	2.05	1.77	1.92
Glllogoc	1.61	1.31	2.14	1.67
Graçanicë	3.29	2.88	1.43	2.55
Hani i Elezit	2.00	3.33		2.57
Istog	1.43	1.21	1.00	1.18
Kaçanik	2.00	1.50	2.43	2.08
Kamenicë	3.50	1.62	1.70	2.21
Klinë	1.29	1.11	1.20	1.23
Lipjan	1.53	1.68	1.25	1.52
Malishevë	2.00	2.39	1.60	2.09
Mitrovicë	1.83	1.15	1.04	1.30
Mitrovicë Veriore	1.86	1.12	1.14	1.26
Novobërdë	2.00	2.38	2.00	2.23
Obiliq	2.00	8.25	1.70	3.38
Pejë	1.35	1.51	1.54	1.45
Podujevë	1.91	1.54	1.40	1.65
Prishtinë (ARBK)	1.98	1.92	2.04	1.98
Prizren	1.73	1.13	1.22	1.35
Rahovec	1.93	1.80	4.67	2.43
Shtërpcë	8.00	1.00		4.50
Shtime	1.60	3.75	1.33	2.38
Skenderaj	2.96	1.06	1.75	2.18
Suharekë	2.17	3.50	2.00	2.60
Viti	1.50	1.54	1.29	1.44
Vushtrri	2.59	1.65	2.40	2.16
<b>Mesatarja</b>	<b>1.92</b>	<b>1.68</b>	<b>1.80</b>	<b>1.79</b>

\*Ngjyra e kuqe paraqet mesatare të madhe të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

\*Ngjyra e gjelbër paraqet mesatare të vogël të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

## V. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE

Tabela 2 më poshtë paraqet numrin e shoqërive tregtare të regjistruara dhe numrin e shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës ligjore të shoqërisë tregtare dhe muajit të regjistrimit për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2017. Për dallim nga raportet e kaluara ku forma më e regjistruar ka qenë Biznesi Individual, të dhënat në këtë tremujor tregojnë se forma ligjore e shoqërive tregtare më e regjistruar është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar, e ndjekur nga Biznesi Individual. Forma ligjore me numrin më të madh të çregjistrimeve është Biznesi Individual dhe SHPK-ja.

Tabela 2: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara dhe çregjistruara sipas formës ligjore, korrik - shtator 2017:

Regjistrimi sipas formës ligjore	Muaji	Biznes Individual	Ortakëria e Përgjithshme	Ortakëria e Kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	Shoqëri Aksionare	Dega e Kompanisë së Huaj	Kooperativa Bujqësore	Totali
Shoqëri Tregtare të Regjistruara	Korrik	365	1	-	363	2	5	1	737
	Gusht	420	1	-	406	2	2	-	831
	Shtator	322		-	345	1	5	-	673
	<b>Totali</b>	<b>1,107</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>1,114</b>	<b>5</b>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>2,241</b>
Shoqëri Tregtare të Çregjistruara	Korrik	73	1	-	6	1	1	-	82
	Gusht	94	4	-	13			-	111
	Shtator	99		-	6			-	105
	<b>Totali</b>	<b>266</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>25</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>298</b>

## VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA SIPAS VENDIT TË ORIGINËS

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, kompania e huaj përkufizohet si një shoqëri tregtare që është themeluar dhe aktualisht ekziston sipas një ligji të një juridiksioni jashtë Kosovës dhe e cila mund të angazhohet në aktivitete afariste në Kosovë përmes regjistrimit të një dege në Kosovë në ARBK. Tabela 3 më poshtë tregon numrin total të degëve të kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, për periudhën korrik - shtator 2017.

Tabela 3: Degët e kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë sipas vendit të origjinës, korrik - shtator 2017:

Vendi i origjinës së kompanive të huaja	Degët e kompanive të huaja
Turqia	4
Zvicra	3
Shqipëria	2
Gjermania	1
Maqedonia	1
Holanda	1
<b>Totali</b>	<b>12</b>

## VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ

Të dhënat në Tabelën 4 paraqesin numrin e shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj. Gjatë periudhës korrik - shtator 2017 janë regjistruar gjithsej 2,241 shoqëri tregtare nga të cilat 186 kanë një person të huaj fizik ose juridik si pronar, ortak ose aksionar. Nga ky numër janë përjashtuar degët e kompanive të huaja që janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 4: Numri i shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, korrik – shtator 2017:

Muaji	Biznes Individual	Ortakëria e Përgjithshme	Ortakëria e Kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	Shoqëri Aksionare	Kooperativa Bujqësore	Totali
Korrik	10		1	47	1	-	58
Gusht	8	1	1	62	1	-	72
Shtator	15			41		-	56
<b>Totali</b>	<b>33</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>150</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>186</b>

\*Këto të dhëna nuk paragjykojnë përqindjen e kapitalit të personave të huaj. Qëllimi i kësaj table është paraqitja e pjesëmarrjes së personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë në shoqëri tregtare në Kosovë.

\*Nga kjo tabelë është përjashtuar numri i "Degëve të Kompanive të Huaja" që është paraqitur në Tabelën 3.

Nga 2,241 shoqëri tregtare të regjistruara gjatë kësaj periudhe në Kosovë, numri total i personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë është 249. Siç mund të shihet në Tabelën 4, forma ligjore më e regjistruar e shoqërive tregtare në mesin e personave të huaj është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar. Gjithashtu, në Tabelën 3 mund të shihni numrin total të degëve të kompanive të huaja të regjistruara gjatë kësaj periudhe, i cili është 12.


## VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË

Të dhënat në Grafikon 4 dhe 5 paraqesin pjesëmarrjen gjinore në shoqëritë tregtare të regjistruara gjatë periudhës 1 korrik - 30 shtator 2017. Për shkak të natyrës të formave të ndryshme ligjore të shoqërive tregtare, të dhënat më poshtë paraqiten ndaras për Bizneset Individuale, të cilat kanë pronar të vetëm dhe janë zakonisht biznese të vogla, dhe ndaras për format ligjore të tjera të shoqërive tregtare ku pronarët marrin pjesë si ortakë apo aksionarë në shoqëri tregtare më të mëdha ose më diverse.




Grafiku 4 tregon përqindjen e pronarëve femra dhe meshkuj në Biznese Individuale. Edhe pse pjesëmarrja e femrave në regjistrim të Bizneseve Individuale është ende relativisht e ulët, të dhënat tregojnë një trend në rritje të pjesëmarrjes së tyre.

Grafiku 4: Përqindja e Bizneseve Individuale sipas Gjinisë, korrik – shtator 2017:



Grafiku 5 tregon përqindjen e ortakëve ose aksionarëve të shoqërive tregtare sipas gjinisë të regjistruar gjatë periudhës korrik – shtator 2017, me përjashtim të bizneseve individuale dhe degëve të kompanive të huaja.

Grafiku 5: Përqindja e Ortakëve dhe Aksionarëve sipas Gjinisë, korrik - shtator 2017



## IX. PËRFUNDIM

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në mënyrë që të përmirësoj akoma më shumë efikasitetin e regjistrimit në ARBK ka ndërmarrë një sërë veprimesh:

- Ka iniciuar zhvillimin, institucionalizimin dhe përdorimin e rregullt të matjeve të performancës duke nxjerrë nga të dhënat zyrtare të regjistrimit për të monitoruar kohën për përpunimin e aplikacioneve për regjistrim nëpër qendrat komunale të regjistrimit dhe për të identifikuar performuesit më të mirë si dhe ata më të përmirësuarit;
- Ka rritur fokusin në sigurimin e pajtueshmërisë me Ligjin për Shoqëritë Tregtare që aktualisht është në proces të ndryshim-plotësimit;

Publikimi i raporteve të rregullta të matjes së performancës të përgatitura dhe publikuara nga ARBK shërbejnë si mjet informues për përmirësimet e mëtutjeshme të procesit.

Projekti i USAID-it Partneritetet për Zhvillim do të vazhdojë të përkrahë këtë qasje deri në institucionalizimin e plotë.

# FAKTE TË SHPEJTA LIDHUR ME REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË

Më poshtë mund të gjeni një përmbledhje të shpejtë të të dhënave të paraqitura në raportin “Indikatorët Bazë të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë” për periudhën korrik - shtator 2017.

Ky raport dhe kjo përmbledhje janë përgatitur nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me mbështetjen e Projektit të USAID-it Partneritetet për Zhvillim.

Këto të dhëna paraqesin shifra të ndryshme, duke filluar nga mesatarja e ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare e deri tek numri i shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një person i huaj si pronar, ortak ose aksionar.

## PËRMBLEDHJE PËR PERIU DHËN KORRIK – SHTATOR 2017



## PËRMBLEDHJE PËR PERIUDHËN 1999 – SHTATOR 2017

